

20210771166

LIGJ I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TE BANKA EUROPIANE E RINDËRTIMIT DHE E ZHVILLIMIT SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "VENDOSJE E TRANSPORTIT TË SHPEJTË ME AUTOBUS NË QYTETIN E SHKUPIT"

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua te Banka Europiane e Rindërtimit dhe e Zhvillimit në vlerë prej 70.000.000 euro, e paracaktuar për financimin e projektit "Vendosje e transportit të shpejtë me autobus në qytetin e Shkupit".

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e përdorimit të huas së nenit 1 të këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen e huas që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshja e huas e paragrafit 1 të këtij neni nënshkruhet nga ministri i Financave.

Neni 3

Huamarrja e nenit 1 të këtij ligji do të jepet në dy këste. Kësti i parë është në vlerë prej 47.600.000 euro, dhe kësti i dytë është në vlerë prej 22.400.000 euro.

Afati i shlyerjes së kështit të parë të kredisë është 15 vjet me grejs periudhë prej katër vjet të përfshirë. Pjesa e parë e huas do të shlyhet në 22 këste gjashtëmujore më 20 prill dhe 20 tetor të çdo viti, duke filluar nga data e parë e përfundimit të vitit të katërt të lidhjes së Marrëveshjes së huas.

Periudha e shlyerjes së kështit të dytë të kredisë është 15 vjet me grejs periudhë prej katër vjet të përfshirë. Pjesa e dytë e kredisë do të shlyhet në 22 këste gjashtëmujore më 20 prill dhe 20 tetor të çdo viti, duke filluar nga data e parë e përfundimit të vitit të katërt nga data e disponueshmërisë së përdorimit të kështit të dytë.

Norma e interesit është e ndryshueshme dhe përbëhet nga një EURIBOR gjashtë-mujor i zmadhuar me margjinë prej 1%.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% të shumës së kështit të parë në afat prej shtatë ditëve nga efektiviteti i kështit.

Në afat prej shtatë ditëve nga dita e disponueshmërisë për përdorimin e kështit të dytë, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% të shumës së kështit të dytë.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit provizion për mjetet të patërhequra në shumën prej 0,5% të kredisë vjetore.

Për shumën e mjeteve të patërhequra nga kredia për kështin e parë, provizioni do të fillojë të llogaritet pas 60 ditësh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së huas të nenit 1 të këtij ligji, dhe provizioni për fondet e patërhequra për kështin e dytë do të fillojë të llogaritet pas shtatë ditësh nga dita e disponueshmërisë për përdorimin e kështit të dytë.

Neni 4

Projekti do të zbatohet nga Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe të Lidhjeve.

Neni 5

Për realizimin e projektit të nenit 1 të këtij Ligji, Qyteti i Shkupit do të lidhë Marrëveshje Projekti me Bankën Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit.

Neni 6

Me qëllim të rregullimit të të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rrjedhin nga Marrëveshja e huas të nenit 2 të këtij Ligji dhe Marrëveshjen e Projektit të nenit 5 të këtij Ligji, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve dhe Qyteti i Shkupit do të lidhin Marrëveshje Implementim.

Neni 7

Republika e Maqedonisë së Veriut do të shlyejë huan e nenit 1 të këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 8

Qarkullimi i mallrave dhe i shërbimeve të kryera në Qytetin e Shkupit, i paracaktuar për projektin "Vendosje e transportit të shpejtë me autobus në qytetin e Shkupit", i financuar me Marrëveshjen e huas të nenit 2 të këtij Ligji përjashtohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e heqjes së tatimit të mëparshëm.

Importi i mallrave/shërbimeve nga Qyteti i Shkupit, i destinuar për projektin "Vendosje e transportit të shpejtë me autobus në qytetin e Shkupit", financuar nga Marrëveshja e huas të nenit 2 të këtij Ligji, përjashtohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar, taksat e importit, akciza e energjentëve dhe taksa e automjeteve motorike për makinat për udhëtarë.

Për qarkullimin e bërë në Qytetin e Shkupit, për qëllimet e projektit "Vendosje e transportit të shpejtë me autobus në qytetin e Shkupit", financuar nga Marrëveshja e huas të nenit 2 të këtij ligji, për të cilin i njëjti është debitor tatimor në përputhje me nenin 32 pikën 4 dhe nenin 32-a të Ligjit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar lirohet nga detyrimi për të llogaritur dhe paguar tatimin mbi vlerën e shtuar.

Tatimpaguesi i cili kryen qarkullim për të cilin është i liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, detyrimisht, përveç emrit të marrësit të mallit ose përdoruesit të shërbimit, në faturë shënon emrin e projektit dhe emrin e Marrëveshjes së huas të nenit 2 të këtij ligji.

Qyteti i Shkupit gjatë importit të mallrave/shërbimeve të liruara në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, duhet të paraqesë te autoriteti doganor kompetent një kopje të Marrëveshjes së huas të nenit 2 të këtij ligji dhe deklaratë se mallrat e importuara janë të paracaktuara për realizimin e projektit "Vendosje e transportit të shpejtë me autobus në qytetin e Shkupit", financuar me Marrëveshjen e huas të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 9

Të mirat/mallrat që janë përjashtuar nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar, taksat e importit, akciza për energjentë dhe taksa e automjeteve motorike për automjete për udhëtarë bazuar në nenin 8 paragrafi 2 të këtij ligji, në afat prej tre vjetësh nga dita e importit nuk mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të jepen hua ose të përdoren ndryshe për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, taksat e importit, akciza e energjisë dhe taksa e automjeteve motorike për makinat për udhëtarë. Të mirat / mallrat nuk mund të lihen peng, me qira ose si siguri për detyrime të tjera.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, të mirat/ mallrat që përjashtohen nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar, taksave të importit, akcizës për karburantin dhe tatimin për automjetet motorike për automjetet e udhëtarëve bazuar në nenin 8 paragrafi 2 të këtij ligji mund t'i jepen për përdorim vetëm Ndërmarrjes Publike të Transportit "Shkup" pa paguar më parë detyrimet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Nëse mbajtësi i së drejtës, para kalimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, synon të përdorë të mirat / mallrat që u përjashtuan nga pagesa e detyrimeve nga neni 8 paragrafi 2 të këtij ligji për qëllime të tjera, dhe jo për ato për të cilat ato ishin përjashtuar nga detyrimet, paraqet kërkesë për pagimin e borxhit doganor tek autoriteti doganor.

Shuma e borxhit doganor të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni llogaritet nga organi doganor në bazë të elementeve për përcaktimin e taksave që ishin të vlefshme në momentin e paraqitjes së kërkesës për pagimin e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave të paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni, shuma e borxhit doganor do të llogaritet në bazë të elementeve për përcaktimin e taksave doganore në kohën e pranimit të deklaratës doganore, në bazë të të cilave mallrat u përjashtuan nga taksat e importit.

Neni 10

Prokurimet e mallrave, të mirave dhe të shërbimeve të paracaktuara për realizimin e projektit të përmendur në nenin 1 të këtij Ligji do të kryhet në përputhje me Udhëzuesin e Prokurimeve të Bankës Europiane të Rindërtimit dhe të Zhvillimit.

Prokurimet e mallrave, të mirave dhe të shërbimeve të paracaktuara për realizimin e projektit të nent 1 të këtij ligji do të zbatohet nga Qyteti i Shkupit.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".